



Republika e Kosovës / Republik of Kosova

Komuna e Obiliqit / Municipality of Obiliq

Duke u mbështetur në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitete jashtëshkollore, kërkesës me numër të protokollit 2873/302 nga SHML GJ "17 Shkurti" në Obiliq, dhe pëlqimit nga DKA-it, me 29.03.2019 shpallë:

F T E S Ë P Ë R O F E R T Ë

SHML Gjumnazi "17 Shkurti" në Obiliq, organizon ekskursion 4 -ditor (3 -ditë bujtje), për në Shqipëri. Ftojme agjencitë turistike të licesuara që të konkurrojnë për organizimin e ekskursionit në Republikën e Shqipërisë për maturanët të SHML Gjumnazi "17 Shkurti" në Obiliq.

Ekskursioni planifikohet të realizohet prej datës **30.04.2019** me këtë itinerar:

- Obiliq –Prizren – Vizitë Kalasë së Krujës, vendosja në hotel,
- Durrës- Vlorë- (Shtëpia e Pavarësisë, Monumentet Historike) - Durrës i vjetër,
- Durrës –Berat (Vizitë qytetit muze) - Tiranë,
- Nisja për Kosovë. Lezhe- Shkodër (Vizitë varrit të Skënderbeut, Kalaja e Shkodrës).

Oferta duhet të përfshijë vetëm itinerarin e paraqitur më lartë dhe duhet të përfshihet vetëm një çmimi, në të kundërtën oferta nuk do të merret në konsideratë nga komisioni.

Në ofertë duhet të paraqitet itinerari, çmimi për nxënës, hoteli, racionet, menyuja e ushqimit.

Ekskursioni do të organizohet për 4 ditë kalendarike.

Pagesën për vizite të monumenteve historike mbulohet nga kompania fituese.

Të drejtë pjesëmarrje në ofertë kanë të gjitha agjencionet që plotësojnë këto kushte të përgjithshme:

- Të jetë i licencuar
- Certifikatën e biznesit dhe informatori i kompanisë
- Numri fiskal
- **Gjendjen teknike të autobusëve, sipas procedurave ligjore, me prioritet të lartë (siguria e nxënësve)**
- Të kenë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës
- Autobusët të jenë komfort dhe me klimë
- Agjensioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- Agjensioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit.
- Agjensioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.

❖ **Vend qëndrimi ose hoteli i preferuar hoteli AS, ose (Bonita-objekti i ri)!**

Dorëzimi: Oferta e përpiluar në formë të kërkuar duhet të vendoset në pliko të mbyllur dhe të vulosur nga ana e ofertuesit, si dhe të shkruhet qartë oferta për ekskursion për maturanët e SHML Gjumnazi "17 Shkurti" në Obiliq. Ftojme të interesuarit të aplikojnë nga data 29.03.2019, ofertuesit mund të aplikojnë 7 ditë nga data e shpalljes.

Dokumentet dorëzohen në arkivin e komunës, deri më 05.04.2019, në ora 14:00.

Hapja e ofertave: Hapja e ofertave do të bëhet më datë: **05.04.2019**, në ora **14:30**.

Zeqir Hashani, drejtor